



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 370 prot

Tiranë, më 21.7. 2025

VENDIM

Nr. 5 datë 21.7. 2025

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 21/7/2025

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 21.7.2025 vendosi:

1. Për projektvendimin “**Mbi Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”**”, propozuar nga Ministri i Shtetit të Pushtetit Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimiشت dakord me projektvendimin.
2. Për projektvendimin “**Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, të ndryshuar”**”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Në nenin 12, pika 3, të ulet koha e arkëtimit të të ardhurave nën 90 ditë;
  - Në nenin 11, të rishikohet kufiri për çdo objekt mbi 5 kate dhe propozohet që kufiri të jetë të paktën në 6 kate;
  - Pavarësisht parashikimeve të nenit 18, të kësaj rregulloreje, për lejet e ndërtimit të lëshuara nga autoritetet e zhvillimit të territorit, të cilave u ka përfunduar afati i vlefshmërisë dhe afati i kërkesës, por pa teikaluar afatin e përcaktuar në pikën 6, të nenit 40 të Ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, subjektet zhvilluese mund të aplikojnë për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit dhe autoritetet e zhvillimit mund tëshqyrtojnë kërkuesat në systemin elektronik të lejeve të ndërtimit brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.
3. Për projektvendimin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, dhe zhvillimin e akuaklulturës në sipërsfaqe publike, tokësore dhe ujore, të ndryshuar”**, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Në nenin 13 të këtij projektvendimi, të shtohet togfjalëshi “në administrim” ose “në pronësim”, në mënyrë që të specifikohet qartë se cilit institucion i referohet.
4. Për projektligjin **“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”** propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të rishikohen tarifat e parashikuara në projektligj për sanksionet kundrejt bashkive;
  - Në neni 24, gërmë f dhe nenet 31 dhe 34, përcaktohen përgjegjësitë për standarde dhe bashkëpunim, por mungon qartësia për një standard unik të detyrueshëm minimal dhe procesin e miratimit pas konsultimit me NJVV-të;
  - Në neni 24, pika 1, parashikohet trajtim në qendra të specializuara, por mungon qartësimi për detyrimet e bashkive për magazinim të përkohshëm dhe transportin e tyre;
  - Në nenin 13, pëershkruan si më parë rolin dhe përgjegjësitë në nenin 24. Problematike është zbatueshmeria , e cila varet nga aktet nën ligjore për:
    - a) Cilat janë rrymat e mbetjeve që duhet të ndërtojë sistemin NJVV-ve, nuk paraqiten në nenin 31 pika 2c (ndonëse në nenin 65 referohen 5 rryma, por jo qartësisht si rryma, por më shumë si kategori mbetjesh). Kjo mungesë specifikimi pengon të gjithë mënyrën e organizimit në nivel vendor, për shembull grumbullimi me 2 rryma (pra dy kazane: të njoma e të thata) apo me shumë rryma. Në varësi të kësaj dalin dhe kostot dhe mënyra e trajtimit të metejshëm.

- b) Kostot e ndërtimit të sistemit mbeten të paspecifikuara, por lihet të nënkuçtohet se Fondi i ekonomisë së Mbetjeve mund të mbështesë nismat në NJVV-të, nuk citohet.
- c) Në nenin 31 gërmë c kërkon që NJVV-të të marrin masa për funksionimin e sistemit që mbetet evazive. Të sqarohet nëse hartimi i Planit konsiderohet masë, dhe nëse jo, cilat janë masat e parashikuara?
- d) NJVV nuk ka të specifikuar rolin për rrymat e mbetjeve të rrezikshme, të cilat janë problematikë më vete, ndërkohë që i gjithë ligji kërkon të rregullojë mbetjet urbane. Më tej do të ketë rregullime edhe për mbetjet e rrezikshme, por kjo duhet paraparë në sistemin që çdo NJVV duhet të ngrejë.
- Në nenet 28 dhe 29 projektligji parashikon mbështetje në mënyrë të përgjithshme, por nuk e përmend specifikisht që fondet e AKEM janë për mbështetjen e NJVV, siç rekomandohet ("...në mbështetje të NJVV");
- Në nenin 71, të sqarohen roli i AKEM dhe AKM dhe shmangia e raportimeve të dyfishta. Projektligji nuk specifikon qartë ndarjen e roleve dhe mënyrën e shmangies së aprotinin të dyfishtë nga bashkitë;
- Parashikimi i penaliteteve për operatorët që nuk raportojnë të dhëna te bashkitë. Projektligji nuk përmban penalite për operatorët fundorë në rast mosdhënie informacioni ndaj bashkive;
- Në nenin mbi kostot e transportit dhe trajtimit fundor, ndonëse Shtojca 6 përmend kontribut të buxhetit të shtetit, mungon një formulim i qartë në tekstin ligjor për ndarjen e kostove të transportit dhe depozitimit midis bashkive dhe nivelit qëndror.

5. Për projektvendimin **"Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shtjen, eksportin, importin, administrimin dhe trasportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standaret teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale"**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.
6. Për projektvendimin **Projektvendimi "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të integruar mjedisor"**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Përfshirjen në sistem për nevojat që mund të jenë specifike për bashki të caktuara, në mënyrë që bashkitë të kenë mundësi të shtojnë fushat e raportimit dhe marrjes së të dhënave;
  - Brenda sistemit të shtohet një element i ri, i cili do të shërbejë si paralajmërim kur leja është drejt përfundimit ose nëse i ka kaluar afati;
  - Bashkitë kufitare të kenë mundësinë të bashkëpunojnë dhe të koordinohen për raportimin e elementeve mjedisorë në zonat ndërkufitare.

7. Për projektvendimin “**Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimateve dhe viktimateve të mundshme të trafikimit**”, propozuar nga Ministria e Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Hartimi dhe përdorimi i formularëve të posaçëm për intervistimin dhe trajtimin/menaxhimin e rasteve nga strukturat përgjegjëse. Këta formularë do të shërbejnë si një mjet standard për të mbledhur të dhëna të strukturuara, për të identifikuar nevojat individuale, për të dokumentuar ndërhyrjet e kryera dhe për të monitoruar vazhdimisht cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve të ofruara;
  - Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave të shërbimeve sociale të qeverisjes vendore dhe punonjësve të komisariateve të policisë, në mënyrë që të lehtësohet dhe të përshpejtohet plotësimi i formularit të Identifikimit Parësor (PSV) për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet që lidhen me fëmijët në situatë rruge, të cilët angazhohen në aktivitete si lypja, pasi këta fëmijët përbëjnë një grup me rrezik të lartë për trafikim;
  - Projektvendimi ngarkon Drejtorinë e Shërbimeve Sociale dhe Njësinë për mbrojtjen e fëmijëve në NJVV. Trajtimi i rasteve, përvèç procedurave do të kerkojë dhe buxhete të shtuara, sidomos për periudhën e emergjencës. Të parashikohet kërkesë përfondëse të deleguara për trajimin e rasteve, viktima të trafikimit të mitur e të rritur.

**Z. Arbjan MAZNIKU**  
**Ministër Shteti për Pushtetin Vendor**

**Z. Aldrin DALIPI**  
**Kryetar/Bashkëkryetar**  
**Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë**

